



BASHKIA MIRDITË
SEKTORI MZSH

Nr. 2575/Prot.

Rrëshen, me 11/07 /2023

SHPLLJE VENDE TË LIRA PUNE NË SEKTORIN MZSH (SHËRBIMI I
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI)

BASHKIA MIRDITË

Mbeshtetur ne ligjin 139 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore" Bazuar në ligjin Nr. 152/2015 " Për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi " "Vendimi nr 520 date 25.07.2021 Rregullorja per Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi" Si dhe ne baze te struktures dhe organikes se Sektorit Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ne Bashkin Mirdite Nr 24 date 24.10.2019

Kriteret për pranimin e kandidatëve.

1. Kandidati për pranimin në nivelin bazë të shërbimit vendor të MZSH-së duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet etjere të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- ë) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) cm.
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "D1";



Kandidati për personelin drejtues automjetesh zjarrfikëse dhe shpëtimi në shërbimin e MZSH-së duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi automjeti, grupi "D1", si dhe me leje drejtimi të veçantë shërbimi, konform kërkesave të Kodit Rrugor. Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist etj.

Dokumentacioni i aplikimit:

Aplikanti paraqet në njësinë e burimeve njerëzore dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Formular aplikimi;
- b) Fotokopje e kartës së identitetit;
- c) Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit;
- ç) Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "D1";
- d) Certifikatë e gjendjes gjyqësore;
- dh) Certifikatë familjare;
- e) Vërtetim nga gjykata;
- ë) Vërtetim nga prokuroria;
- f) Raport mjeko-ligjor;
- g) Fotokopje e librezës së punës;
- gj) Vërtetim banimi;
- h) Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

Afati për dërgimin e CV-ve është deri më datë 27.07.2023

** Aplikimi behet duke dërguar CV-në dhe kërkesën për punësim në pozicionin e dëshiruar tek protokollin e Bashkisë:*

Pas verifikimit paraprak në datën 30.07.2023, do të shpallet lista e konkurentëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë. Konkurimi do të bazohet në njohuri specifike për pozicionin e punës të cilat kanë të bëjnë me:

Të gjitha njoftimet për shpalljen e vendit të lirë të punës, rezultatet e verifikimit paraprak si dhe datën kur do zhvillohet testimi, i gjeni në adresën email personale të kandidatëve.

Shefi Sektorit MZSH
Agim LLESHAJ

